

## **Fjala e ministrit Bushati në Konferencën: “Shqipëria, 60 vjet në UNESCO”**

Dëshiroj së pari të shpreh kënaqësinë e veçantë që së bashku me kolegë ministra, personalitete të fushës së kulturës, studiues, aktorë të ndryshëm qeveritarë e shoqërorë, përfaqësues nga UNESCO, marr pjesë në këtë fazë të parë të festimeve të 60 vjetorit të anëtarësimit të vendit në UNESCO. Pas pak javësh, në periudhën 19-23 nëntor, do të zhvillohen në Paris aktivitete shtesë për të shënjuar edhe në Selinë e Organizatës, këtë moment të rëndësishëm.

Sot mbushen plot gjashtë dekada nga dita e anëtarësimit të Shqipërisë në UNESCO. Si pjesë e zinxhirit të sistemit të Kombeve të Bashkuara, UNESCO u themelua për të zhvilluar solidaritetin intelektual dhe moral të njerëzimit, si një instrument ndërqeveritar për të ndërtuar paqe të qëndrueshme. Pas më shumë se shtatë dekadash, mund të themi pa droje se aktiviteti i saj ka ndihmuar në ndryshimin e jetës dhe ndërtimin e së ardhmes për miliona vetë, ka ndikuar në mënyrën se si njerëzit në mbarë globin e shohin dhe kuptojnë njëri-tjetrin dhe në tërësi botën në të cilin jetojmë.

Shqipëria e kohës së anëtarësimit në UNESCO, siç e tha pak më parë dhe Mirela, ka qenë një tjetër, kryekëput ndryshe nga Shqipëria e sotme, demokratike, moderne, e zhvilluar, e etur dhe pakthyeshem e angazhuar për progres. Nuk ka shumë për të thënë për praninë, rolin dhe kontributin tonë në UNESCO – si edhe në pjesë të tjera të aktivitetit shumëpalësh, gjatë dekadave nën regjimin komunist. Megjithatë, përpos kufizimeve drastike të imponuara nga diktatura, orientimit ideologjik, paranojës dhe vet-izolimi ndërkombëtar, prania në UNESCO e ndihmoi Shqipërinë të luftonte analfabetizmin në përpjekje për të nxjerrë vendin nga një prapambetje e theksuar.

Me ndryshimet rrënjësore të sistemit politik në vend, ndërveprimi ynë me UNESCO-n e vuri në qendër nevojën për mbështetjen për integrimin e vendit në botë, ndryshimin e imazhit dhe rritjen e shikueshmërisë, mbështetjen për lirinë e shprehjes, përmirësimin e sistemit arsimor, ndërtimin e shtetit ligjor dhe demokracisë, ndërtimin dhe funksionimin e shoqërisë civile dhe qytetarisë, mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore përmes politikave të reja si dhe, në mënyrë të veçantë, mbrojtjen dhe nxitjen e të drejtave të njeriut.

Në harkun kohor të tre dekadave, Shqipëria është bërë palë e të gjitha konventave kryesore të UNESCO-s, ka marrë pjesë aktive në diskutimet mbi çështje madhore të agjendës së organizatës dhe i'a ka dalë të përfshijë në regjistrat e ndryshëm të UNESCO-s një numër pasurish që përfaqësojnë dhe nxjerrin në pah vlerat universale të padiskutueshme e të vyera të trashëgimisë tonë kulturore, shpirtërore, natyrore. Butrinti, Beratit, Gjirokastra, Isopolifonia, “Kodikët e Purpurt të Beratit”, Pyjet e Hershëm Ahorë të Lumit të Gashit dhe Rajcës, Rezerva e Biosferës së Prespës, janë tashmë faqe të ndritura në pasaportën tonë kulturore dhe natyrore, pjesë e trashëgimisë botërore dhe regjistrave të tjerë ndërkombëtarisht të njohur e botërisht të vlerësuar.

Një tjetër dosje rëndësishme, ajo e Rajonit të Ohrit, është aktualisht nën shqyrtim dhe ne kemi besim se vitin e ardhshëm ajo do të bëhet një margaritar në gjerdanin e Trashëgimisë Botërore.